



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 16.07.2013
Nr. 0204-913

PËR: Nexhmedin Arifi, Kryetar i Komunës së Vitisë
Skenderbe Hebibi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË VITISË,
NR. 01/13-551 të Pranuar me datë, 09.07.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me nenin 82 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit nr.01/13-551 të miratuar me datën 28.06.2013 nga Kuvendi i Komunës së Vitisë, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Akti juridik i listuar si vijon, ka efekt të plotë juridik.

- Vendim nr. 01/13-551 për caktimin lokacionit për ndërtimin e monumentit për dëshmorin Florin Maliqi në ngastrën kadastrale nr.284-0 Sadovinë e Çerkezëve.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana, 16.07.2013
Br. 0204-913

Za: Nexhmedin Arifi, Gradonačelnik Opštine Vitina
Skenderbe Hebibi, Predsedavajući Skupštine Opštine Vitina

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE VITINA,
BR. 01/13-551 primljeno dana, 09.07.2013

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odrdjenim prema članu 82 Zakonu br. 03-L-040 za lokalnu samoupravu, dodatak XII Uredbe Vlade Nr.02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke br.01/13-551 usvojene dana 28.06.2013 od Skupštine Opštine Vitina, **POTVRDJUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti u skladu sa Zakonom br. 03/L-040 za Lokalnu samoupravu i Zakonu Br.04/L-144 za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine .

Pravni akt niže navaden ima puni pravni efekat.

- Odluka br. 01/13-551 o odredjivanju lokacije za izgradnju spomenika za palog borca Florin Maliqi u kadastralnoj parceli br.284-0 Sadovina Čerkeza.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanikpremijera & Ministar MALS-a

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukopodiocima Uprava MALS-a
Arhivu MALS-a



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

OPŠTINA E VITISË - OPŠTINA VITINA

09-07-2013

01-013/551

Nr. Urdhri	Nr. Urdhri	Nr. Urdhri	Nr. Urdhri
Org. broj	Org. broj	Org. broj	Org. broj

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVES VLAKA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO

Administrimit të Pushtetit Lokal
Lokale Samouprave i Administracije
Local Government Administration

09.07.2013

Nr. Urdhri	Nr. Urdhri	Nr. Urdhri	Nr. Urdhri
Org. broj	Org. broj	Org. broj	Org. broj

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 40.2 pika 1 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 35.2 pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 28.06.2013, merr

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E MONUMENTIT PËRKUJTIMOR
PËR DËSHMORIN FLORIN MALIQI NË NGASTREN KADASTRALE 284-0 Z.K.
SADOVINË E ÇERKEZËVE

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, CAKTON lokacion për ndërtimin e monumentit (Lapidarit) për kujtimor për Dëshmorin Florin Maliqi i rënë në Betejën e Koshares për çlirimin e Kosovës nga pushtuesi serb.

Neni 2

Vendi – lokacioni për ndërtimin e monumentit për kujtimor nga neni 1 i këtij vendimi caktohet në Z.K. Sadovinë e Çerkezëve, në anën e majtë të rrugës Sadovinë e Çerkezëve – Sllatinë, në ngastrën kadastrale nr.284-2 në pronësi të P.Sh. Komuna e Vitisë dhe ka një sipërfaqe prej 400 m² me dimensione të ofruara nga Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 3

Vendimi nga neni 1 i këtij Vendimi është miratuar nga Kuvendi i Komunës në bazë të propozimit të Drejtorisë për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi dhe kërkesës së Këshillit të fshatit Sadovinë e Çerkezëve me nr. 07/07/490 të datës 10.06.2013.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Kadastër
2. Këshillit të fshatit
3. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDI
Skenderbe Hebibi

Skenderbe Hebibi